



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E KULTURËS DHE ARSIMIT

Nr. 4579 Prot.

Roskovec, më 18.06. 2026

PROJEKT-VENDIM

NR. ____ DATË 18.06 2026

PËR

DHËNIËN E TITUJVE "QYTETAR NDERI" TE BASHKISË ROSKOVEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13 si dhe në VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie e medalieve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim

1. Propozim për Dhënie e Titujve "Qytetar Nderi" te Bashkisë Roskovec, si më poshtë :

a. Siku Spiro Kola me motivacionin:

"Për kontributin e shquar në çështjen kombëtare, si pjesëmarrës në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, për angazhimin në mbrojtjen e kufijve të vendit, veprimtarinë patriotike dhe rolin e tij në organizimin e pushtetit vendor gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe për shërbimin me përkushtim ndaj komunitetit të Roskovecit, duke lënë një trashëgimi të vyer historike dhe atdhetare për brezat."

b. Thanas Dhimitër Kristuli me motivacionin:

"Për kontributin e çmuar si farmacist dhe veprimtar në shërbim të shëndetit publik, për përkushtimin profesional dhe human në ndihmë të qytetarëve të Roskovecit, për pjesëmarrjen

dhe mbështetjen e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe për ndershmërinë, profesionalizmin dhe vlerat qytetare që la si trashëgimi në komunitet."

2. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë, ngarkohet Komisioni Këshillimor për Dhënie të Titujve Vendorë të Nderit për kryerjen e procedurave përkatëse.

Konceptoi: B. Cjapi


Konfirmoi: M. Goga

Për drejtorinë juridike



Kryetar
Majlinda Bafi

*Në mungesë e urdhërimit
ZV. KRYETARI
MAKSI M. GOGA*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E KULTURËS DHE ARSIMIT

Nr. 4576/1 Prot.

Roskovec, më 18.06. 2026

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për dhënien e titujve "Qytetar Nderi" qytetarëve të Bashkisë Roskovec

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC
Roskovec

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13 i Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medalieve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";

Kryetari i Bashkisë Roskovec ka paraqitur propozimin për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Roskovec për 2 (dy) personalitete të shquara të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në Bashkinë Roskovec për çështen kombëtare dhe luftën Nacional-Çlirimtare duke e shoqëruar me jetëshkrimin (biografinë) dhe dokumentacionin përkatës.

Propozimi kaloi për shqyrtim në Komisionin Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit, të ngritur me Urdhër të Brendshëm të Kryetares së Bashkisë Nr. 36, datë 05.03.2024 "Për krijimin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit".

Paraqesim për diskutim dhe miratim projekt-vendimin për Dhënien e Titujve "Qytetar Nderi" qytetarëve të Bashkisë Roskovec, konkretisht:

1. Siku Spiro Kola

Siku Spiro Kola lindi më 15 gusht 1875 në një familje të shtresës së mesme. Që në rininë e tij u dallua për ndjenjat e forta atdhetare dhe për angazhimin në çështjet kombëtare, duke u bërë një nga figurat më të respektuara të zonës së Roskovecit.

Ai mori pjesë në ngjarjen madhore të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 në Vlorë, si një nga 15 përfaqësuesit e rrethit. Pas formimit të Qeverisë së Ismail Qemalit, iu bashkua vullnetarisht forcave ushtarake shqiptare për mbrojtjen e kufijve jugorë të vendit nga ndërhyrjet greke, duke marrë pjesë në luftime deri në Janinë.

Më pas, qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës e caktoi kryeplak të fshatit Jagodinë, detyrë të cilën e ushtroi me përgjegjësi dhe përkushtim. Ai mbështeti lëvizjen demokratike të udhëhequr nga Avni Rustemi dhe kontribuoi në shtrirjen e veprimtarisë së Shoqërisë "Bashkimi" në zonën e Roskovecit, duke ndihmuar në përhapjen e ideve përparimtare dhe demokratike.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, shtëpia e tij u kthye në një bazë të rëndësishme të forcave partizane, ku u strehuan drejtues të luftës dhe luftëtarë të plagosur. Edhe familjarët e tij morën pjesë aktive në luftë që nga krijimi i çetës partizane në vitin 1943.


Siku Spiro Kola luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e pushtetit të Këshillave Nacionalçlirimtare në Jagodinë dhe në të gjithë zonën e Roskovecit, duke qenë një figurë me autoritet të lartë dhe gëzues i respektit të komunitetit.


Pas çlirimit të vendit, ai shërbeu si kryetar i Komitetit për zbatimin e Reformës Agrare dhe si përfaqësues i popullit në Këshillin e Përgjithshëm të Frontit në qarkun e Beratit, duke kontribuar në proceset e rëndësishme të zhvillimit dhe organizimit të jetës shoqërore.

Për kontributin e tij të shquar në çështjen kombëtare dhe në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, pas vdekjes u nderua me titullin "Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it".

Siku Spiro Kola u nda nga jeta më 18 maj 1957, duke lënë pas një figurë të respektuar atdhetare dhe një trashëgimi të çmuar në historinë e Roskovecit. Veprimtaria e tij në shërbim të kombit dhe komunitetit mbetet një shembull frymëzues për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

*He munges e uolke -
EV PAVARËSIA
MAKSIM KOLA*





2. Thanas Dhimitër Kristuli

Thanas Dhimitër Kristuli lindi më 15 mars 1915 në lagjen Mangalem të Beratit, në një familje qytetare të shtresës së mesme. Që në moshë të re shfaqti interes për shkencat mjekësore dhe u përgatit profesionalisht në fushën e farmacisë.

Pas përfundimit të praktikës profesionale në Lushnjë, iu përkushtua profesionit të farmacistit. Nga viti 1938 deri në vitin 1943 punoi në disa farmaci në qytetin e Beratit, ku u dallua për profesionalizmin, korrektësinë dhe përkushtimin ndaj pacientëve.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dha kontribut të vyer si me armë në dorë, ashtu edhe në ndihmën mjekësore për luftëtarët dhe të plagosurit, duke vendosur profesionin e tij në shërbim të çështjes së lirisë së vendit.

Pas çlirimit, hapi një farmaci private në Skrapar, ku ushtroi profesionin deri në shtetëzimin e saj. Më pas u emërua farmacist në Roskovec dhe më vonë u rikthye sërish në Skrapar. Në vitin 1956 u vendos përfundimisht në Roskovec, ku vazhdoi të shërbente me përkushtim deri në fund të jetës së tij.

Puna e tij profesionale u karakterizua nga ndershmëria, përgatitja e lartë dhe përkushtimi ndaj shëndetit të qytetarëve. Për kontributin e tij të çmuar u dekorua me "Medaljen e Punës" nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr. 2376, datë 17.12.1956.

Krahas angazhimit profesional, ai ndërtoi një familje shembullore së bashku me bashkëshorten e tij, Kondelinën, me të cilën rriti gjashtë fëmijë, duke përballuar me dinjitet dhe përkushtim sfidat e kohës.

Thanas Dhimitër Kristuli u nda nga jeta më 9 qershor 1972, duke lënë pas kujtimin e një profesionisti të përkushtuar, patrioti dhe qytetari të respektuar. Kontributi i tij në shërbim të shëndetit publik dhe komunitetit të Roskovecit mbetet një dëshmi e vyer e vlerave njerëzore, profesionale dhe atdhetare që ai përfaqësoi gjatë gjithë jetës së tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !

Konceptoi: B. Cjapi
Konfirmoi: M. Goga



KRYETAR
Majlinda Bufi

*Ne manpa e urdhe -
EU KRYETARI
MAKSIM GOGA*

